



VENDIM

K.P.P. 845/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.12.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Blerje Shtypshkrimesh*”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi, Tiranë.

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Cerciz Topulli”, nr.17, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare sh.a.
Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, nr. 4, Tiranë.

Subjekt i Interesuar:

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 10, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 02.05.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Blerje Shtypshkrimesh”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2 Në datën 04.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 24.09.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|-------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. "Albdesign PSP" shpk, | 40,927,380.00 lekë, Skualifikuar; |
| 2. "Marketing & Distribution" shpk, | 41,457,839.00 lekë, Kualifikuar; |
| 3. "Kristalina-KH" shpk, | 42,500,000.00 lekë, Skualifikuar; |
| 4. "Adel Co" shpk., | 43,879,365.50 lekë, Kualifikuar; |

II.4.Në datën 27.09.2018 operatori ekonomik ankimues "Adel Co" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga "Marketing & Distribution" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.4.1.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2828/1 Prot. datë 04.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimues "Adel Co" sh.p.k, duke e refuzuar atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

'[...]1. Lidhur me pretendimin "Skualifikimin e operatorit ekonomik M&D për mospërmbushje të pikës 2.1.d", Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka dorëzuar, vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike nëpërmjet të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka paguar detyrimet konform pikës 2.1.d të shtojcës 1 të DST-ve.

Në shtojcën 1 të DST-ve citohet: " Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Operatori ekonomik M&D ka paraqitur një vërtetim debie lëshuar nga OSHEE për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në përputhje me kriterin e sipërcituar dhe jo të provojë mungesën e një titulli pronësie mbi kontratën për furnizim me energji elektrike. Sa më sipër gjykimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik M&D sh.p.k., rezulton në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

2. Lidhur me pretendimin "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërmbushje të pikës 2.2.1 Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka dorëzuar, vërtetimin për shërbime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, konform pikës 2.2.1 të DST-ve. Konkretisht Operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim për realizim kontrate me OSHEE me vlerë 69,127,961.60 (gjashtë dhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë) lekë për kontratën me objekt "Kancelari dhe të ndryshme". Në ankimin tuaj ju citoni se kontrata e lidhur me OSHEE ka objekt kancelaritë, ndërkohë ju sqarojmë se në kontratë ka zera që kanë objekt shtypshkrimet, të cilat jo vetëm që e përmbushin vlerën prej 39% po dhe e tejkalojnë atë. Sa më sipër gjykimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik M&D sh.p.k., rezulton në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

3. Lidhur me pretendimin "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërmbushje të pikës 2.2.3 Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion që vërteton disponimin për të gjitha makineritë të cilat janë të kërkuara

në pikën 2.2.3 të DST-ve. Në lidhje me kontratën e qirasë për makinerinë CTP, në ankesë ju shpreheni se: "Ne mendojmë se nuk e mbulon të gjithë periudhën e përcaktuar" ju sqarojmë se kontrata e qirasë e paraqitur nga operatori i sipërcituar në ankesën tuaj për makinerinë CTP është në përputhje me parashikimet e Kodit Civil në fuqi dhe mbi bazën e rregullave të caktuara për redaktimin e akteve noteriale të parashikuara nga ligji "Për Noterinë". Në lidhje me makinerinë e shtypit në rulon dhe makinerisë së telefonimit për të cilat ju shpreheni në ankesën tuaj: "Ne mendojmë se kjo Shoqëri nuk i disponon këto makineri", sqarojmë se Operatori ekonomik M&D ka paraqitur dokumentacion që dëshmon disponimin e makinerisë në rulon dhe makinerisë së telefonimit. Në lidhje me makineritë për mbledhjen e letrës dhe për birosjen e letrës, ju sqarojmë, se Operatori Ekonomik M&D ka paraqitur dokumentacion që dëshmon disponimin e makinerisë për mbledhjen e letrës dhe për birosjen e letrës. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

4. Lidhur me pretendimin "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërbushje të pikës 2.2.4 Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion që vërteton disponimin e makinerisë dixhitale për printimin e të dhënave variable të cilat janë të kërkuara në pikën 2.2.4 të DST-ve. Sa më sipër gjykimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik M&D sh.p.k., rezulton në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

5. Lidhur me pretendimin për "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërbushje të pikës 2.2.5 Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e Operatorit ekonomik dhe rezulton se: Në pikën 2.2.5. të Dst-ve citohet: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente) Si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente) Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka paraqitur Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente) si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente) të cilat janë të kërkuara në pikën 2.2.5 të DST-ve. Sqarojmë se në pikën 2.2.5 të DST-ve kërkohen përkatësisht: Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente) si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente) por nuk citohet që këto Certifikata Iso duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit. Në lidhje me akreditimin në pikën 2.2.5 të DST-ve, është kërkuar që Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit dhe nuk është kërkuar të jetë e akredituar për lëshimin e certifikatave në fushën e shtypshkrimeve. Sa më sipër gjykimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik M&D sh.p.k. në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

6. Lidhur me pretendimin për "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërbushje të pikës 2.2.6 Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Në pikën 2.2.6. të Dst-ve citohet: Operatori Ekonomik duhet të disponojë ambjent pune dhe magazinimi për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Në rast se ambjenti është në pronësi të Operatorit Ekonomik, ky i fundit duhet të paraqesi certifikatën e pronësisë së ambientit. Në rast se ambjenti është marrë me qera, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë qeraje të noterizuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KSHA konstaton se operatori ekonomik "M&D" sh.p.k. ka paraqitur kontratë qiraje ku ka vërtetuar disponimin e një ambjenti pune për realizimin e

kontratës objekt prokurimi. Në ankimin tuaj ju shpreheni se operatori "M&D" bashkëlidhur kontratës së qirasë duhet të kishte paraqitur certifikatën e pronësisë së objektit, kur ndërkohë në DST, certifikata e pronësisë së objektit është kusht për t'u paraqitur vetëm në rast se ambjenti është në pronësi të Operatorit Ekonomik. Pra operatori i sipërcituar në ankimin tuaj nuk e kishte të detyrueshme certifikatën e pronësisë së objektit pasi ka paraqitur kontratë qiraje të noterizuar. Sa më sipër gjykimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik M&D sh.p.k., rezulton në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

7. Lidhur me pretendimin për "skualifikimin e Operatorit Ekonomik M&D për mospërbushje të pikës 2.2.7", Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar mostrat e paraqitura dorazi nga ana e operatorit ekonomik dhe rezulton se: Të gjitha mostrat e paraqitura në ditën dhe në datën e hapjes së ofertave janë të përputhje të plotë me specifikimet teknike sipas shtojcës 10 të Dokumentave Standarte të Tenderit. Vlerësimi i ofertës të ofertuar në këtë procedurë është në zbatim dhe mbështetje të pikës 3, të nenit 53, Shqyrtimi i Ofertave, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (me ndryshimet), ku citohet: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.[...]"

II.4.2.Në datën 11.10.2018 operatori ekonomik ankimues "Adel Co" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...] a. Ne dokumentat standarte te tenderit, ne piken 2.1.d te kriterëve te vecanta per kualifikim, ne piken d, percaktohet: "Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri." . Ne mendojme se kjo shoqeri nuk ka paraqitur dokumentacionin e duhur ne permbushje te kriterit te percaktuar ne dokumentat e tenderit. Kjo per faktin se ka paraqitur nje vertetim, i cili nuk pasqyron pagimin e detyrimeve te energjise per te gjitha adresat qe ka operatori (Niptet sekondare). Ne kriterin e percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit, kerkohet qarte se duhet konfirmuar shlyerja per te gjitha kontratat qe ka operatori ekonomik. Ne nenin 27 "Kontrata te mallrave", pika 5, germa "c" te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, percaktohet qe: [...] Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike autoriteti kontraktor kerkon: c)një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik". Referuar parashikimit te mesiperm ligjor, ky operator ekonomik nuk e ka vërtetimin per shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike ne perputhje me VKM-ne si me siper. Ky operator eshte thjesht perdorues i disa prej kontratave te qirase qe ka, dhe kjo behet zakonisht per te shmangur tarifimin e ndryshem qe i behet kontratave te energjise elektrike te biznesit te cilat kane nje tarifim me te larte krahasuar me kontratat per abonentet familjare. Kontrata per furnizimin me energji elektrike eshte nje kontrate qe lidhet midis Operatorit te Shprendarjes se Energjise Eleknike dhe konsumatorit te energjise elektrike. Duke marre parasysh permbajtjen e ketyre kontratave "tip", ne asnje nen te kontrates nuk

thuhet qe sherbimi qe ofrohet nga kjo kontrate mund te kaloje me ane te nje kontrate tjeter perdorimi apo cfaredolloj kontrate. Gjithashtu theksojme se para te treteve, apo para edhe vete Operatorit te Shperndarjes se Energjise Elektrike, per kete kontrate dhe per sherbimin e ofruar pergjigjet vetem personi qe ka ne pronesi kontraten e furnizimit dhe jo personi qe e ka ne perdorim kete kontrate. Le te marrim nje shembull te thjeshte, ne lidhje me faturimin e energjise, faturim i cili dhe ne fature shkruhen ne emrin e titullarit te kontrates, edhe pse ky sherbim mund te perdoret nga nje perdorues i cili mund te kete nje kontrate qiraje objekti, nese perdoruesi pas njefare kohe nuk pranon ti paguaje keto detyrime, personi pergjigjes per pagimin e ketij sherbimi eshte direkt titullari i kontrates, pasi vete Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike nuk e ka nje kontrate me perdoruesin e energjise elektrike. Pra, ne kushtet kur operatori "Marketing& Distribution" sh.p.k ka nje kontrate qiraje objekti, ky operator, se bashku me kontraten e qirase se objektit, duhet te kishte shkuar prane OSHEE sh.a dhe te bente kalimin e pronesise per kontraten e furnizimit me energji elektrike nga emri i pronarit te objektit me te cilin ka lidhur kontraten e qirase mbi objektin, ne emrin e personit juridik konkret. Ky eshte nje parashikim ligjori shprehur me VKM, parashikim te cilin kjo firme nuk e ka zbatuar. Duke patur parasysh qe qellimi i kerkimit te vertetimit te shlyerjes se detyrimeve te energjise elektrike per operatoret ekonomike qe jane pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik, i parashikuar me VKM nr. 379, date 11.06.2014, eshte qe ata te vertetojne kapacitetet ekonomike dhe teknike per realizimin me sukses te kontrates qe prokurohet. Ne rastin kur nje operator eshte thjesht perdorues i nje kontrate qiraje dhe nuk eshte pergjegjes apo nuk pergjigjet me nje kontrate qiraje me te cilen te rezultojte titullar, nuk ofron kredibilitet apo besueshmeri per realizimin me sukses te kontrates qe prokurohet, pasi ne nje periudhe te mevonshme ky operator mund te mos pergjigjet per keto detyrime dhe mbi te nuk bie asnje pergjegjesi ligjore e drejteperdrejte. Ne vertetimin e energjise elektrike te paraqitur nga kjo firme, duhet te jete e shprehur qartesisht se kjo firme eshte perdorues i kontratave te qerases dhe jo titullar i te gjitha ketyre kontrateve. Nderkohe qe qellimi qe ligjvenesit e parashikoi kete kriter dhe qe shprehimisht thuhet ne VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", "te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik", i referohet vetem kontratave mbi te cilat nje person eshte titullar. Nje praktike e tille eshte mbajtur edhe me pare nga ana e KPP, ku vlen te theksojme vendimin nr. 117/2015, date 24.03.2015, ku shprehet se operatori qe nuk e ka ne pronesi kontraten e furnizimit me energji elektrike nuk e ploteson kriterin e parashikuar nga VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik". Duke iu referuar konceptit disponim si nje koncept ligjor, kuptojme se disponimi eshte nje nga tagrat e pronesise. Pronesia ne vetvete ka tre tagra qe jane, disponim, posedim dhe perdorim. Disponimi eshte i vetmi tager qe jep titullin pronar, dhe qe jep te drejten e tjetersimit te sendit apo te se drejtes qe ka ne pronesi, njekoheisht ka te drejta dhe detyrime te pakufizuara kundrejt pronarit. Nderkohe qe posedimi eshte e drejta me ate te te ciles nje person mund te marre te drejta dhe detyrime mbi nje send apo mbi nje te drejte, por nuk mund ta tjetersojte sendin apo te drejten. Nderkohe perdorimi, si tager i pronesise ka me pak te drejta dhe detyrime kundrejt dy tagrave te pare. Pra, ky operator, ne kuader te perdoruesit te kesaj kontrate, dhe ne kuader te pjesemarrjes ne procedurat e prokurimit publik, procedura te cilat jane me ndikim te drejteperdrejte ne interesin publik, nuk ofron besueshmeri dhe nuk ploteson kapacitetet e vendosura nga ligji per permbushjen me sukses te kontrates qe prokurohet. Persa me siper, ne mendojme se ky operator duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure. Gjithashtu, ne mendimin tone, shoqeria ka paraqitur dokumentacion bashkengjitur vertetimit, qe liston kontratat qe operatori ekonomik ka ne dispozicion, per te provuar shlyerjen e energjise, por ky dokument eshte i pavlefshem sepse nuk permban te dhena te personit perfaqesues se OSHEE sh.a dhe as vulen e OSHEE sh.a, gje e cila nuk ofron garancine qe

kjo liste nuk eshte ndryshuar nga operatori ekonomik ne varesi te interesave te tij. Pra, ky operator ekonomik nuk provon qe ka shlyer detyrimet ligjore per pagimin e energjise elektrike per te gjitha kontratat qe ky operator ka. Persa me siper operatori ekonomik nuk jep siguri per realizimin me sukses te kontrates qe prokurohet.

b. Ne kriteret e kualifikimit per kapacitetin teknik, pika: 2.2.1 percaktohet:

"Përvojë e suksesshme ; Shërbime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." Ne mendojmë se kjo shoqëri nuk ka paraqitur në tender dokumentacion në përmbushje të kriterit sikurse është kërkuar në dokumentat e tenderit. Kjo shoqëri ka paraqitur kontrata apo fatura tatimore me objekt kryesisht kancelari dhe nuk kanë të bëjnë me objektin që prokurohet dhe kurrsesi nuk mund të konsiderohen në cilësinë e kontratave të ngjashme. Referuar dhe klasifikimit të bërë nga legjislacioni i prokurimit publik, natyra e shtypshkrimeve është një natyrë e një lloji tjetër dhe që nuk ka lidhje me fushën e produkteve kancelari. Kjo gjë evidentohet edhe nga praktika që ndiqet nga autoritetet kontraktore në prokurimin e këtyre mallrave, duke filluar nga vete Posta Shqiptare që e bën diferencimin midis këtyre fushave si autoritet kontraktor, ku prokuron vecmas shtypshkrimet dhe vecmas kancelarite, pra në procedurë prokurimit të ndryshme dhe të ndara nga njëra tjetra. E njëjta praktikë ndiqet edhe nga autoritetet e tjera kontraktore ku kancelarite prokurohen me vete dhe shtypshkrimet me vete, ose minimalisht të ndara në lote në ndryshme dhe kontratat e ngjashme paraqiten të ndryshme për secilin lot. Për më tepër, kemi të bëjmë me dy lloje të ndryshme kontratash, pasi kontratat e kancelarive janë kryesisht kontrata malli (furnizimi), nderkohe kontratat konkrete që prokurohet është kryerja e shërbimit të printimit (pra është kontratë shërbimi) sipas nenit 28 të VKM nr. 914, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar. Ne mendojmë se kjo shoqëri ka paraqitur në tender një kontratë të lidhur me OSHEE sh.a, gjë që cilën e vertetojnë edhe AK në përgjigjen e tij, të cilat kanë për objekt furnizimin me kancelari dhe furnizime me kliente private, të cilat gjithashtu janë furnizime me objekt kancelarie dhe që nuk mund të konsiderohen në cilësinë e kontratave të ngjashme përse i përket kësaj procedure prokurimi. Në shërbimet e mëparshme të ngjashme të paraqitura në përputhje me kërkesën e përcaktuar në DST, ne mendojmë se vlera e shtypshkrimeve të paraqitura nga kjo shoqëri që rreth 4,000,000 leke, gjë që nënkupton se kjo vlerë nuk është e barasvlefshme me vlerën e përcaktuar në kriterin e mësipërm nga Posta Shqiptare. Serish AK hedh poshtë këtë pikë me argumentin se në kontratë ka zëra që kanë objekt shtypshkrimet, të cilat jo vetëm që përmbushin vlerën prej 39 % por edhe e tejkalojnë atë." Ju bëjmë me dije se paraqitja e kontratave është kërkuar specifikisht në kushtin që ato të jenë me natyrë të ngjashme. Pra, autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë që kontrata e paraqitur nga M&D sh.p.k përmbush kriterin, vetëm sepse pretendon se tejkalohet vlera. Sic e thamë, shtypshkrimet dhe kancelarite, janë të ndara nga njëra tjetra dhe paraqitja e një kontrate kancelarish nuk i shërben kësaj procedure. Gjithashtu, ne mendojmë se shtypi në atë kontratë që rreth 4,000,000 leke dhe nuk përmbush kriterin e shënuar më sipër. Thëksojmë se në kushtet që shtypshkrimet postare janë shtypshkrime të një karakteri të vecantë, mosfunksionimi i tyre do të sillte një kaos jo vetëm kombëtar por gjithashtu edhe nderkombëtar, pasi sikurse dihet shërbimi postar ofrohet edhe në nivel nderkombëtar. Sikurse është e parashikuar në tender, kerkohen jo shtypshkrime të një karakteri të zakonshëm, por të një karakteri krejt të vecantë sikurse janë barkodet të cilat

realizohen me ane te algoritmeve te percaktuara. Ne mendojme se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Marketing& Distribution" sh.p.k në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, nuk mund të konsiderohet si i ngjashem me objektin e prokurimit. Referuar praktikës së nxjerre nga KPP për këto kriter, rendesia e kontratave të ngjashme është thelbësore dhe janë një element i rendesishëm që ndihmojnë në krijimin e bindjes së autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet.

c. Në dokumentat standarte të tenderit, në piken 2.2.3 percaktohet se Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri parapërgatije CTP;
- makineri shtypi në rrulon;
- makineri telefonimi;
- makineri për mbledhjen e letrës;
- si dhe makineri për biosjen e letrës.

Disponimi i makinerive të mesiperme të vertetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontratë qeraje të noterizuar.

Në kemi bindjen se shoqëria "Marketing Distribution" shpk nuk plotëson kriterin si më sipër. Kjo shoqëri nuk i disponon makineritë sipas kërkesës së percaktuar në DST.

i. Përsa i përket kontratës së qerave për makinerinë CTP ne mendojme se kjo kontratë qeraje nuk e mbulon të gjithë periudhën e percaktuar. Për më tepër, ne mendojme se objekti i kontratës mund të jetë dhënë me qera për një periudhë edhe më të gjatë nga sa është marrë vetë objekti me qera, gjë e cila është në kundërshtim me ligjin. Pra, një send (makineria) që është marrë për shembull për dy muaj me qera, nuk mund të leshohet serish me qera, për 6 muaj. Ne mendojme se kjo qëndron jashtë logjikës dhe nuk verteton disponimin e makinerisë nga ana e operatorit apo kapacitetin teknik të tij. Kjo formë e paraqitjes së dokumentacionit për makineri nuk është e saktë as nga ana ligjore, sepse sic e thamë, një send i marrë me qera për një afat dy muajor, nuk mund të jepet serish me qera për një periudhë më të gjatë. ii. Përsa i përket makinerisë së shtypit në rrulon dhe makinerisë së telefonimit, ne mendojme se kjo shoqëri nuk i disponon këto makineri. Ne mendojme se në përmbushje të kësaj pike kjo shoqëri ka paraqitur një kontratë qeraje në të cilën nuk ka paraqitur asnjë dokument bashkëngjitur kontratës së qerave që të mund të vertetojë pronesinë e qiradhenesit mbi këto makineri. Ne mendojme se kjo shoqëri si dokumentacion që verteton pronesinë e qiradhenesit pretendon se qëndrojnë pasqyrat financiare perkatese të qiradhenesit. Kjo kontratë qeraje që ky operator mund të ketë paraqitur është një kontratë e pavlefshme pasi nuk është bërë në përputhje me parashikimet e Kodit Civil në fuqi dhe mbi bazë të rregullave të caktuara për redaktimin e akteve noteriale të parashikuara nga Ligi "Për Noterine". Për analogji i referohemi mjeteve dhe makinerive që operatori ekonomik i ka në pronesi të tij, nëse legjislati i prokurimit publik do të mjaftohej me këto formë vertetimi makinerish atëherë pse do të kishte percaktuar ndarazi kapacitetin ekonomik dhe financiar (ku parashikohen kërkesa e AK për pasqyrat financiare), dhe vecmas kapacitetin teknik ku kerkohen makineri dhe pajisje që shërbejnë për realizimin me sukses të po të njëjtes kontrate. Në kemi bindjen se pasqyrat financiare të kerkuara nga legjislati kanë një tjetër qëllim, dhe jo vertetimin e asteteve, pasi sikurse dihet bilancet pasqyrojnë aspektin financiar të shoqërisë deri më datë 31 dhjetor të çdo viti, dhe ky bilanc mbyllet brenda muajit mars të vitit pasardhës. Pasqyrimi në bilanc i një asemi kurrsesi nuk garanton që ky aset nuk mund të jetë shitur menjëherë pas mbylljes së bilancit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky aset mund të mos ekzistojë. Në Ligjin për Prokurimin Publik nuk njihet praktika e vertetimit të disponimit të makinerive përmes paraqitjes së bilancit. E vetmja formë disponimi janë dokumentat e zhdoganimit të mallit apo faturat tatimore të blerjes. Një gjë e tillë nuk parashikohej

as ne dokumentat standarde te tenderit. Per kete arsye, operatori nuk e ka permbushur kriterin si me siper dhe duhet te skualifikohet nga procedura. Per me teper, ne kete kriter eshte percaktuar se ne rastin kur operatori i ka ne pronesi duhet te paraqese faturen tatimore te blerjes ose deklaraten e zhdoganimit. Pra, edhe ne rastin e marrjes me qera nga shoqeri tjeter duhej te vertetohej minimalisht disponimi i makinerive nga qeradhenesi ne nje nga format e percaktuara ne kete kriter, pra me fature tatimore blerje ose me deklarate zhdoganimi. M&D sh.p.k duket qarte se nuk ka paraqitur as faturat tatimore te blerjes, as deklaratat e zhdoganimit dhe keto dokumenta nuk mund te zvendsohen kurrsesi nga pasqyrat financiare. Pervec kesaj, pasqyrat financiare as nuk jane audituar qe te ofrojne pak me teper siguri qe jane hartuar ne rregull dhe konfrom rregullave dhe standarteve kombetare dhe nderkombetare te kontabilitetit. Persa me siper ne mendojm se Shoqeria Marketing & Distribution shpk nuk i disponon makinerite si me siper dbe perpasoje duhet te skualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

iii. Shoqeria Marketing & Distribution shpk nuk disponon makineri per mbledhjen e letres dhe makineri per birosjen e letres. Ne mendojme se ne permbushje te kesaj pike kjo shoqeri ka paraqitur nje kontrate qeraje e cila eshte pavlefshme dhe nuk ka kurrfare vlere ligjore pasi kesaj kontrate nuk i eshte bashkengjitur nje dokument qe verteton pronesine e qeradhenesit mbi objektin e qerases. Ne informacionin tone, qeradhenesi keto makineri pretendon se i ka fituar ne nje procedure ankandi dhe per kete mendojme se keto makineri nuk shprehin asnje siguri mbi objektin e qerases. Ne mendojme se kjo shoqeri ka paraqitur kete dokument ne permbushje te ketij kriteri, duke ja bashkengjitur kete akt nga permbaruesi kontrates se qerases se makinerive. Akti i dale nga permbarimi si pasoje e procedures se shitjes ne pasurise ne ankand, eshte nje akt i cili eshte objekt ankimimi, dhe thuajse gjithmone ne fund te aktit percaktohet se kunder vendimit mund te behet ankim brenda 5 ditesh nga marrja dijeni ne gjykatën perkatese. Pra, ky dokument nuk mund te sherbeje kurrsesi si dokument per vertetimin e pronesise pasi nuk vetteteton qe eshte i formes se prere apo qe per kete procedure nuk ka ankim sipas legjislacionit ne fuqi prane gjykates perkates. Pra, disponimi i makinerive ne kete rast nuk vertetohet me ane te nje dokumentacioni qe verteton pronesine. Dokumentacioni i leshuar nga nje shoqeri permbarimore nuk mund te jete kurrsesi nje dokument qe sherben per te vertetuar pronesine e nje sendi pasi nuk perben as titull ekzekutiv, por per te ligji parashikon mundesine e ankimit si nga ana e pronarit ashtu edhe nga ana e pjesemarresve te tjere ne proceduren e ankandit. Ne asnje rast ky lloj dokumenti nuk mund te sherbeje si nje dokumentacion qe verteton pronesine pasi eshte nje ngjarje e pasigurt dhe krijon rrezik potencial per mosrealizimin me sukses te kontrates qe prokurohet, pasi objekti mund te jete objekt shqyrtimi gyqesor ne cdo moment me marrjen dijeni te pronarit te pasurise. Gjithashtu, theksojme se rendesia e vertetimit te ketij kriteri qendron ne faktin se procedurat e prokurimit publik jane procedura te vecanta blerjeje per shkak se kane impakt dhe ndikim te drejtperdrejte ne interesin publik, i cili sanksionohet dhe mbrohet ne nivel konstitucional. Si perfundim, njesoj si ne rastin e meparshem, institucioni juaj eshte shprehur qarte per menyren sesi duhet permbushur ky kriter, pra permes paraqitjes se fatures se blerjes "ose dokumentit te zhdoganimit Akti i leshuar nga permbaruesi nuk verteton disponimin e makinerise pasi mund te rrezohet ne gjykate. Edhe neqofte se e marrim te mirqene, kjo forme nuk eshte e percaktuar ne DST dhe rrjedhimisht nuk i sherben kesaj procedure. Pra, nepermjet fatures tatimore te blerjes/dokumentit te zhdoganimit mund te ofrohet siguri qe sendi objekt kontrate eshte fituar ne menyre te ligjshme dhe qe nuk do te jete objekt kerkimi nga pale te tjera te interesuara (qe mund te shfaqen si pronare te sendit ne te ardhmen duke e bere kontraten absolutisht te pavleshme). Persa me siper, ne mendojm se Shoqeria Marketing & Distribution shpk nuk i disponon makinerite si me siper dhe perpasoje duhet te skualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

iv. Shoqeria Marketing & Distribution shpk nuk disponon makineti per bitosjen e letres. Ne permbushje te ketij kriteri, shoqeria "Marketing & Distribution" shpk nuk ka paraqitur makineri per birosjen e letres. Kjo shoqeri nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per disponimin e kesaj makinerie. Ne rast se Marketing & Distribution shpk do pretendonte se makineria me emertim per mbledhjen e letres me birosje eshte paraqitur ne vend te dy makinerive te kerkuara, ky pretendim nuk qendron pasi ne tender kerkoheshin si dy makineri me vete dhe me funksione te vecanta. Pra, ky operator ekonomik nuk i disponon keto makineri. Qendrimi i autoritetit kontraktor eshte ne kundërshtim edhe me vete DST e pergatitur nga Autoriteti Kontraktor, ku percakton se "Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rrema e te pasakta, konsiderohen si kushte pet skualifikim. Ne kushtet qe operatori Marketing & Distribution shpk nuk i disponon makinerite ne momentin e zhvillimit te procedures se prokurimit, dhe marrja ne konsiderate e ketyre makinerive nga autoriteti kontraktor, eshte element diskriminues per operatoret e tjere pjesemarres ne kete procedure prokurimi, pasi nuk i vendos ne kushte te barabarta konkurimi operatoret ekonomike qe i disponojme keto makineri me operatoret ekonomike qe nuk i disponojne keto makineri.

i. Ne dokumentat standarte te tenderit percaktohet se "Operatori ekonomik duhet te disponoje makineri dixhitale per printimin e te dhenave vadable". Persa i perket kesaj pike te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit, ne mendojme se kjo shoqeri nuk e ploteson kete pike. Ne mendojme se ne permbushje te ketij kriteri kjo shoqeri ka paraqitur dokumentacion qe disponon nje printer (fotokopje) dhe jo makineri dixhitale per printimin e te dhenave variable, duke qene ne kundërshtim me DST. Eshte lehtesisht e evidentueshme qe nje printer i thjeshte zyre nuk mund te realizoje kurrësi printime te te dhenave variable. Ne rast se operatori ekonomik Marketing & Distribution shpk do te pretendonte te kunderten atehere duhet te kishte paraqitur nje karte te teknike te kesaj makinerie ku te pasqyroheshin spektrikimet teknike te kesaj makinerie dhe te specifikoheshin qe kjo makineri sherben per printimin e te dhenave varabel. Theksojme se eshte detyre e operatorëve ekonomike qe nepermjet dokumentacionit te paraqitur ne tender te vertetojne se eshte konform kërkesave te percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit.

j. Ne dokumentat standarte te tenderit, ne kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.2.5. percakton: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Certifikatë ISO 14001:2004 (ose ekuivalente); Si dhe Certifikatë OHSAS 18001:2007 (ose ekuivalente); Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne kemi bindjen se kërkesa e percaktuar si me sipër nuk eshte permbushur sipas parashikimit te bere. Ne kemi bindjen se objekti i certifikatave te shoqerise Marketing & Distribution shpk nuk perputhet me objektin e kontrates qe prokutohet. Pra, ky operator vertet eshte i certifikuar me certifikata ISO 14001 dhe OHSAS 18001, por keto certifikata nuk kane asnje vlere ne rastin e procedures perkatese. Referuar kërkeses per ISO 14001, objekti i certifikates nuk perputhet me objektin e prokurimit shtypshkrime, dhe pervec kesaj sikurse tregohet edhe ne listen qe verteton akreditimin, trupa certifikuese nuk eshte e akredituar te leshoje certifikata per kompanite qe operaojne ne fushen e shtypshkrimeve. E njejta gje edhe per Certifikaten Ohsas 18001. Objekti nuk perputhet me proceduren e prokurimit dhe trupa certifikuese nuk mund te akreditoje kompani ne fushen e shtypshkrimeve. Certifikimi ne fushen e shtypit eshte i ndryshem nga certifikimi ne nje fushe tjeter si per shembull ne fushen e kancelarive, sepse certifikimi ne fushen e shtypshkrimeve nuk nenkupton vetem majtjen dhe magazinimin e mallit, por duke qene se eshte prodhim, lidhet me sigurine e shendetin e punonjesve ne pune dhe mbrojtjen nga rreziqet e profesionit si psh. helmet. Ne baze te legjislacionit nderkombetar per certifikimin me standartet nderkombetare ISO, nje trupe certifikuese mund te

akreditohet per certifikimin me nje standart te caktuar, por ama mund te mos akreditohet qe te certifikoje cdo lloj biznesi apo aktiviteti te mundshem pasi disa aktivitete kane natyre te vecante dhe te ndryshme. Psh, nje trupe certifikuese mund te akreditohet per te certifikuar me ISO 9001:2015 kompani ne fushen e ndertimit, prodhimit te ushqimeve, teknologjive te infomacionit, por mund te mos akreditohet te certifikoj kompani ne fushen e prodhimit te energjise. Pervec faktit si me siper qe trupa certifikuese nuk eshte akredituar ne fushen e veprimtarise se shtypshkrimeve, mendojme qe kjo trupe certifikuese nuk eshte e njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit te Shqiperise, ne kundërshtim kjo edhe me nenin 30 te VKM nr. 914, "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", I ndryshuar, ku percaktohet: "7 1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Autoriteti kontraktor sqaroi se "Ne lidhje me akreditimin ne piken 2.2.5 te DST-ve eshte kerkuar qe certifikatat e mesiperme te jene leshuar nga nje organi i vleresimit te konformitetit, te akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit dhe nuk eshte kerkuar te jene te akredituara per leshimin e certifikatave ne fushen e shtypshkrimeve" Lidhur me kete pergjigjije ne argumentojme se certifikatat e cilesise apo dokumentat ne pergjithesi, ne frymen e legjislacionit kerkohen te jene konform dhe ne perputhje me objektin e prokurimit. Ne kete rast, certifikata e leshuar per nje fushe qe nuk eshte ajo e shtypshkrimeve, nuk i sherben kesaj procedure dhe rrjedhimisht nuk ka vlere. Kjo sepse OE nuk jep sigurine e duhur per kapacitetet, apo nuk verteton se njeh dhe respekton ato standarde qe sigurohen nga pajisja me nje certifikate per fushen ne te cilen operon. Pra, ne perfundim te kesaj pike, themi se Certifikatat e paraqitura nuk jane te leshuara nga organe kompetente te akredituara dhe nuk njihen nga organizma kombëtare te akreditimit ose nderkombetare. Aq me teper theksojme faktin qe trupa certifikuese nuk eshte akredituar per leshimin e certifikatave ne fushen e shtypshkrimeve. Ne mendojme se eshte akredituar per kancelari, ku produkti eshte mall i gatshem por jo ne fushen e shtypshkrimeve ku rreziqet jane me te larta dhe mbrojtjes se shendetit apo sigurise ne teresi i kushtohet nje vemendje me e madhe. Persa me siper, ne kushtet qe shoqeria Marketing & Distribution shpk nuk ka nje sistem per menaxhimin mjedisor dhe per mbrojtjen e shendetit dhe sigurise ne pune, te dyja keto ne fushen perkatese sipas objektit qe prokurohet, kerkojme skualifikimin e kesaj shoqerie nga kjo procedure prokurimi publik.

k. Ne dokumentat standart te tenderit, ne piken i 2.2.6 percakton: Operatori Ekonomik duhet te disponoje ambjent pune dhe magazinimi per realizimin e kontrates objekt prokurimi. Ne rast se ambjenti eshte ne pronesi te Operatorit Ekonomik, ky i fundit duhet te paraqesi certifikaten e pronesise se ambientit. Ne rast se ambjenti eshte marre me qera, Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontra te qeraje te noterizuar. Ne mendojme se kontrata e qerase se objektit nuk eshte e vlefshme pasi nuk ka asnje akt bashkengjitur kontrates qe te vertetoje pronesine e qiradhenesit per objektin e dhene me qera. Ne kushtet qe kjo kontrate eshte lidhur ne kundërshtim me legjislacionin per prokurimin publik, kjo shoqeri duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te disponoje ambiente per prodhimin dhe magazinimin e mallit objekt te kontrates qe prokurohet. Kontrata e paraqitur nga OE nuk eshte ne formen ligjore. Ne nenin 49, te Ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994 „Per Noterine“, i ndryshuar, percaktohet se: Akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve. Akti noterial duhet të përmbajë: dh) tregimin e qartë të sendeve që përbëjnë objektin e aktit me gjithë cilësitë dhe shenjat dalluese të tyre. Kur sendet janë të paluajtshme, tregohen në përbërje të tyre vendi i ndodhjes dhe

kufijtë e saktë. Pra, certifikata e pronësise duhet të jetë pjesë e kontratës së qirase ku të tregohet qarte pjesa që është marrë me qira dhe sic e cituam më lart sipas ligjit për noterinë është pjesë përberëse e kontratës së qirase, pasi në kontratën e qirase, duhet të ishte pjesë sipas ligjit për noterinë: a. Certifikata e pronësise; b. Skica së kush është pjesë e objektit që është marrë me qira dhe vendodhja sipas planit të rëlevimit (pasi sipas ligjit për noterinë, duhet një vendndodhje e detajuar e objektit të qerases); c. Kartat e ID të pronarëve të objektit të marrë me qira dhe të të qiramarresit. Në kontratën e qirase së paraqitur nga kjo shoqëri, mungojnë këto elemente, pasi kjo kontratë në momentin që është hartuar nga noterja, nuk është depozituar asnjë dokument pronësie. Kontrata noteriale duhet të ketë si pjesë integrale të saj dokumentin që verteton pronësinë e qiradhenesit, një kopje e së cilës vëloset nga noteri dhe i bashkëngjitet kontratës, duhet të ketë dokumentet identifikuese të paleve, dhe një plan rëlevimi që tregon një vendndodhje të saktë të pronës, dhe kufijtë e saktë. Pra, këto parashikime ligjore nuk janë zbatuar në rastin e kësaj kontrate. Për pasoje, kjo kontratë nuk është e vlefshme, pasi nuk është bërë sipas formës së kërkuar nga ligji. Duke qenë në mungesë së këtyre elementeve, kjo kontratë nuk ofron bindje që nuk është fiktive pasi dhe vertetimi që ka paraqitur në qoftë se do merret si i saktë tregon se pasuria është truall dhe nuk ka asnjë lloj treguesi që mbi këtë truall ka objekt apo jo dhe në rast kërkohej se duhet objekt me qera dhe jo truall. Kontrata e paraqitur në tender është një kontratë fiktive, dhe nuk është sipas legjislacionit në fuqi. Kjo kontratë nuk është bërë sipas formës dhe rregullave që parashikon ligji “Për noterinë” për redaktimin e akteve noteriale. Dokumenti që verteton pronësinë e qiradhenesit nuk i është bashkëngjitur aktit noterial nga noterja, me vullen e noteres. Pra, në kushtet që ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion bashkëngjitur kontratës së qerases së objektit, ky operator gjithashtu nuk verteton se disponin ambiente magazinimi sikurse percaktohet në dokumentat e tenderit, ambienti i cili është shumë i domosdoshëm për shkak të sasise dhe vëllimit të madh të mallrave që prokurohen me anë të kësaj kontrate. Kontrata e qerases së godinës e paraqitur nga shoqëria Marketing & Distribution shpk, është e pavlefshme (pavlefshmeri absolute) dhe është hartuar në kundërshtim me legjislacionin “Për Noterinë” i ndryshuar. Në kushtet që kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, kjo shoqëri duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë. Për më tepër në mëndojmë se ankesa e kontratës së qerases së objektit, gjithashtu nuk është e saktë pasi nënshkruar nga personat dhe elementet e tyre dalluese, sikurse mund të jetë vula e një shoqërie nuk janë të sakta, pra nuk përkon vula e shoqërisë qiradhenese me vullen që realisht është në kontratë. Pra, në mëndojmë se në kontratë është vula e një shoqërie që nuk ka asnjë lidhje me palet kontraktuese në kontratën e qerases. Për këto arsye, kjo kontratë paraqitet jo në formën e duhur ligjore dhe është e pavlefshme, pasi nuk ofron siguri për procedurën. Duke patur parasysh sa thamë më lart, mëndojmë se kjo kompani duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi. Sipas ligjit “Për Prokurimin Publik”, një nga detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është që nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender nga operatorët ekonomikë, të shihet përputhshmëria me kriteret e kërkuara për kualifikim, dhe të krijohet bindja objektive që një operator ekonomik i disponon kapacitetet ekonomikë, financiare dhe teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë rast, mangësitë në dokumentacionin si më sipër për vertetimin e plotësimit të kriterëve të kualifikimit, përbejnë shkak objektiv që kjo shoqëri të skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi, pasi nuk përmbush kriteret për kualifikim të percaktuara në DST dhe kualifikimi i kësaj shoqërie është bërë në kundërshtim me Legjislacionin e Prokurimit Publik.

-Me konkretisht, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, nga të gjithë pjesëmarrësit në tender u evidentua se të gjithë artikujt me barkodë nuk ishin në formën e duhur, sipas specifikimeve teknike. Kjo për faktin se, gjatë provës nuk njiheshin nga lexuesi i barkodeve. Barkodi nuk ishte prodhuar

sipas algoritmit qe duhet te ndjekin, e percaktuar edhe sipas rregullave strikte te UPU-se, ku nje gabim i vogel ne barkode, ben qe ne perdorimin e perditshem per sherbime postare te sjelle probleme si te percaktoje gabim destinacionet e pakove te letrave. Lidhur me kete ne shtrojme pyetjen nese te gjitha modelet e barkodeve te paraqitura ne tender jane apo jo me algoritem. Nderkohe qe Autoriteti kontraktor u pergjigj me bindje se te gjitha modelet jane ne rregull, ne ju bejme me dije se nuk jane me algoritem ne menyre absolute. Gjithashtu, ne kundersizim me kerkese e DST, ishte paraqitur edhe modeli Formulari CN23+E1 deklarate doganore+ deftese pranimi pet mallra EMS. Ky model u paraqit ne tender ne kundersizim te standardeve te percaktuara ne DST nga institucioni juaj. Letra kimike bashkengjitur fleteve te bllokut nuk ishin me ngjyra te ndryshme dhe te dallueshme nga njera tjetra, sic edhe parashikohet qe te jete per punime te ketij lloji. Ne specifikimet teknike eshte e percaktuar formati, tipi, numri i fleteve dhe ngjyra per secilen kopje te cilat nuk ishin realizuar nga Marketing & Distribution. -Per me teper, modeli i kerkuar Regjister i regjistrimit te regj. per transportimin e informacionit te klasifikuar "sekret shtetror" me te dhena "-blloku me 100 flete me permasa 210x300mm -gjeresia rreshtit 10mm, -e kapur me kapse metalike anesore majtas, -me kapake kartoni". nuk u paraqit sipas ketyre percaktimeve. Ky bllok nuk ishte ne formatin e duhur. Nje faqe e bllokut 270x300 mm ishte punuar ne dy pjese, si dy faqe ne format me perafersi A5, ne kundersizim kjo me specifikimet teknike. Pra, nga format A4, punimi ishte realizuar ne format A5, gjysme formati nga ai i percaktuar ne specifikimet teknike. Edhe pse AK shkruan se "Te gjitha mostrat e paraqitura ne ditin dhe ne daten e hapjes se ofertave jane ne perputhje te plate me specifikimet teknike sipas shtojces 10 te Dokumentave Standarde te Tenderrit," ne , per ta permbledhur mund te themi se te gjitha barkode e paraqitura si modele nga "Marketing & Distribution sh.p.k" si me poshte EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL etj, nuk plotesojne standardet strikte te njohura nga UPU (te cilat percaktojne nje barkod me algoritem sipas standardit Code 128), keto barkode nuk ishin realizuar me formulen perkatese, por ishin thjesht renditje numrash jo funksionale te printuar nga kompjuteri. Ju bejme me dije (sic edhe institucioni juaj na i ka bere te qarte gjate puneve te realizuara), rendesine e ketyre barkodeve per sherbimin postar, mosrakordimi i te cileve sjell qe p.sh nje pako e caktuar me destinacion Itoline te perfundoje ne Kine etj. Po keshtu, formulari i ri i futur se fundmi ne listen e objekteve per prokurim, CN 23 i cili perdoret per deklaratat doganore, eshte percaktuar te jete ne 4 kopje qe shkojne nje per klientin, nje eshte shoqeruese e mallit, nje per institucionin etj. Sic u vu ne pah me lart, keto kopje nuk ishin paraqitur as ne numrin e duhur as ne ndarjen e duhur te ngjyrave, te cilat duhet te jene lehtesisht te dallueshme nga njera-tjetra. Pra, keto modele nuk ishin sipas specifikimeve teknike. Si perfundim, perfaqesuesi jone ne tender vuri re keto mangesi dhe insistoi per vendosjen e tyre ne procesverbal, pasi keto mangesi jane nder arsyet kryesore pse ky operator duhet te ishte skualifikuar nga procedura. Per me teper, mungesa e formule algoritmike e llojit Code 128 ne barkode perben kusht per venien ne dyshim te kapaciteteve te operatorit, sepse produkte kaq specifike, nese nuk realizohen ndikojne direkt ne mbarevajtjen e punes se postes. Kjo gje ka precedente ne procedura te meparshme ku nje operator pjesemarres ne tender nuk realizoi ne formen e kerkuar objektet e parashikuara dhe kjo solli nje problem shume te madh per punen ne institucion. [...]"

II.5.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht:

- Nuk plotësohet pika 2.2.3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit: pasi mungon “Makinëri shtypi në rulon”.

- Nuk plotësohet pika 2.1.c, e kriterëve të veçanta të kualifikimit formulari i ofertës i paraqitur nga operatori ekonomik nuk është sipas shtojcës 1, pasi lloji i procedurës në formular është “Kërkesë për propozim” ndërkohë procedura e prokurimit të procedurë e hapur.

- Nuk plotësohet pika 2.2.4. e kriterëve të veçanta të kualifikimit, seksioni i kapacitetit teknik, pasi kontrata e qirasë e datës 03.09.2018, i mungon dokumentacioni bashkëlidhur kontratës.

- Nuk plotësohet pika 2.2.7 dhe konkretisht për mostrat:

- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 10 etiketa jeshile E10, është e shkruar etiketa jeshile F10.

- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 13 Etiketa Bar Code për kolipostën CP AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi.

- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 15 Etiketa Bar Code për postën RR-AA, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi.

- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 16 Etiketa Bar Code për postën RR-AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi.”

II.5.1.Në datën 28.09.2018 operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij si dhe ngre pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ”Marketing & Distribution” në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.2.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2844/1 Prot. datë 05.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k., duke e refuzuar atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

”[...] 1. Lidhur me pretendimin mbi “Skualifikimin se mungon makineria e shtypit në rulon ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana operatorit ekonomik dhe rezulton se: Në pikën 2.2.3 të DST-së është kërkuar: “Makinëri shtypi në rulon”. Ju nuk keni paraqitur dokument se dispononi makinëri shtypi në rulon. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

2. Lidhur me pretendimin mbi “Skualifikimin se formulari i ofertës ka gabime “, ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga ana operatorit ekonomik dhe rezulton se: Shtojca 1 e formularit të ofertës sipas Dokumentave Standane të Tenderit, ku kërkohet nga ana e operatorit ekonomik të plotësohet: Procedura e prokurimit, Përshkrim i shkurtër i kontratës, përcaktimi i shërbimeve, sasia, çmimi/njësi, çmimi total si dhe afati i kryerjes së shërbimit. Të gjitha këto duhet të plotësohen nga operatori sipas shtojcës së sipërcituar. Formulari i ofertës është standard dhe i patjetërsueshëm. Vlerësimi i ofertës të ofertuar në këtë procedurë është në zbatim dhe mbështetje të pikës 1 “Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme dhe pikës 3, të nenit 53, Shqyrtimi i Ofertave, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (me ndryshimet), ku citohet: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

3. Lidhur me pretendimin "Në lidhje me arsyen e 3-të, të skualifikimit se kontratës së qirasë i mungon dokumentacioni bashkëlidhur ", Ju sqarojmë se: Komisioni i shqyrtimit të ankesave pasi ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga ana juaj në sistemin elektronik nga ku rezulton se: Në përmbushje të pikës 2.2.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit keni paraqitur një kontratë qiraje me datë 03.09.2018, në fund të faqes së parë së cilës citohet: "Sipas dokumentacionit bashkëlidhur kontratës", kur ndërkohë ky dokumentacion nuk ndodhej bashkëlidhur kontratës. Sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion specifik ndryshe nga se është përcaktuar në pikën 2.2.4 të DST-ve, por në kontratën e qirasë së paraqitur nga ana juaj keni cituar togëfjalëshin "Sipas dokumentacionit bashkëlidhur kontratës", e cila nuk ndodhet në vijim të kontratës, duke bërë të pavlefshme kontratën e qirasë të paraqitur nga ana juaj për Makinerinë dixhitale për printimit e të dhënave variabël. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

4. Lidhur me pretendimin "Se njëra nga modelet e dorëzuara për etiketat ngjyrë jeshile e ka emërtimin F10 dhe jo E10 ", Ju sqarojmë se: Në pikën 2.2.7. të Dokumentave Standarte të Tenderit citohet: Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 të përcaktuara në sasisë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Operatori Ekonomik, për artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet të paraqesi të paktën nga 100 copë etiketa për secilin. Barkodi për këto etiketa duhet të realizohet sipas algoritmit të dhënë në specifikimet teknike, pasi në momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet të rezultojë i vlefshëm dhe të lexohet nga sistemi. Gjithashtu për artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile B10, OE duhet të paraqesi nga 100 copë për secilin. Mostra e paraqitur dorazi nga ana juaj dhe konkretisht zëri numër 10 Etiketa Jeshile që ka emërtimin F10, nuk është në përputhje me pikën 2.2.7 të Dst-ve. Në lidhje me pjesën ku shpreheni se këto janë sample ju sqarojmë se vlerësimi i mostrave të paraqitura do të bëhej pikërisht nga sample e paraqitura nga cdo operator ekonomik në procedurën e prokurimit. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

5. Lidhur me pretendimin "se etiketat Bar Code CP-AL, RR-AA, RR-AL, kanë rezultuar të pavlefshme Ju sqarojmë se: Në pikën 2.2.7. të Dokumentave Standarte të Tenderit citohet: Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 të përcaktuara në sasisë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Operatori Ekonomik, për artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet të paraqesi të paktën nga 100 copë etiketa për secilin. Barkodi për këto etiketa duhet të realizohet sipas algoritmit të dhënë në specifikimet teknike, pasi në momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet të rezultojë i vlefshëm dhe të lexohet nga sistemi. Gjithashtu për artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10, OE duhet të paraqesi nga 100 copë për secilin. Mostrat e paraqitura dorazi për etiketat Bar Code CP-AL, RR-AA, RR-AL, në momentin e testimit ka rezultuar të pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. Sqarojmë se AK nuk ngre pretendime mbi teknologjinë e prodhimit të etiketave Bar Code por gjatë testimit me "Bar Code Reader" ka rezultuar që këto etiketa të paraqitura janë etiketa me kode të përsëritura që do të thotë se këto Bar Cod të etiketave janë të përdorura më parë dhe si rrjedhojë janë të pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. [...]"

II.5.3.Në datën 12.10.2018 operatori ekonomik ankimes “Albdesign PSP” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]I kundërshtojme keto arsye si më poshtë.

1. *Per arsyen e pare qe mungon makineria e shtypit ne rulon sqarojme se autoriteti kontraktor nuk e ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria jone pasi kjo arsye nuk qendron. Duam te theksojme se qellimi kryesor i autoritetit tuaj eshte te skualifikoje shoqerine tone duke paraqitur arsye nga me te pakuptimtate. Ne SPE kemi hedhur dokumentin me emertimin Kontrate qera makineri qe eshte kontrate qeraje e lidhur ne daten 03.09.2018 ndermjet shoqerise Albanian Digital Printing Solution and Services dhe Albdesign PSP me objekt marrjen me qera te makinerive: Makineri shtypi dixhitale ne rulon qe printon edhe te dhenat variabel ne nje kalim DCP 500 Xeikon 2 cope ku pjese perberese jane edhe karakteristikat kryesore te makinerise, njera makineri eshte mare per te plotesuar kriterine e vendosur nga ana e AK per makineri shtypi ne rulon dhe tjetra kriterin tjetër te vendosur per printimin e te dhenave variabel (kjo del nga karaktersitikat kryesore te makinerise te pershkruara ne te). Ne pergjigjen e sjelle nga ana e AK per makinerine shtypi ne rulon autoriteti kontraktor ka dhene nje pergjigje te shkurter te pabazuar dhe pa argumenta, duke thene qe nuk e disponojme por pa dhene asnje sqarim mbi pretendimet tona ne te cilat kemi sqaruar shume mire qe ne disponojme makineri shtypi dixhitale ne rulon por autoriteti kontraktor nuk do ta marre parasysh kete dokumentacion dhe argumentimin dhe sqarimin e dhene nga ana jone.*

2. *Per arsyen e dyte te skualifikimit se formulari i ofertes ka gabime se procedura e prokurimit eshte shkruar "Kerkese per propozim" dhe jo "Procedure e Hapur" sic eshte ne te vertete procedura, shprehim se ky eshte nje lapsus kalemi i cili nuk e cenon kete formular oferte apo nuk e ben te pavlefshem ate per nje lapsus te tille pasi kjo nuk eshte se sjell pasoja per kete formular nderkohe qe te gjitha te dhenat e tjera te ketij formulari jane te plotesuara te sakta dhe konform formularit. Madje shtojme ketu se ne raste te tilla te ngjashme te lapsuseve te tilla edhe vete Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur kete qendrim duke i quajtur gabime te tilla qe nuk prekin ne thelb oferten. Perderisa ne kete formular jane plotesuar te gjitha te dhenat e tjera te cilat jane te domosdoshme, ky detaj i shkruar gabim mund edhe te mos plotesohet nga ana e operatorit ekonomik pasi nuk cenon rendesine e dokumentit ne fjale. Nuk mundet qe per nje lapsus kalemi te tille, autoriteti kontraktor te beje skualifikimin e shoqerise me vlere me te ulet me nje arsye absurd te paqenesishme qe as devijim te vogel nuk mund te konsiderohet pasi eshte aq minor sa nuk e tjeterson kete formular oferte, pasi percaktimi i llojit te procedures ne kete formular eshte nje detaj qe edhe mund te mos ishte plotesuar dhe kjo nuk do te perbente shkak skualifikimi. Ne lidhje me formularin e ofertes autoriteti kontraktor citon nene pa fund duke thene se formulari i ofertes eshte i patjetersueshem si edhe se nuk duhet te lejohet ofrohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme. Duam te kundërshtojme keto argumenta te pabaza e te pasakta te autoritetit kontraktor sepse ne kete rast nuk kemi tjetërsim te formularit te ofertes aq me teper qe ska nderhyrje ne oferte per ta kthyer nga te pavlefshme ne te vlefshme pasi nga ana jone nuk eshte bere ndonje gabim esencial qe cenon apo ndryshon te gjithë thelbin e ofertes, pasi vetem percaktimi i llojit te procedures se prokurimit e cila mund te ishte edhe e paplotesuar si ne te shumten e rasteve, nuk cenon ne thelb dhe nuk prek absolutisht formularin e ofertes sone e cila permban te gjithë elementet e domosdoshme dhe te kerkuar te cilet e bejne oferten tone shume te sakte e te patjetersueshme dhe te vlefshme.*

3. Ne lidhje me arsyen e 3 te skualifikimit se kontrates se qerases i mungon dokumentacioni bashkelidhur kontrates, kjo arsye skualifikimi se pari nuk e kuptojme se cfare dokumentacioni i mungon pasi autoriteti kontraktor nuk ka specifikuar asgje por thjesht se kontrates i mungon dokumentacioni pa thene se cili dokumentacion mungon. Nderkohe nga ana tjeter sqarojme se kontrata e qerases e lidhur ne daten 03.09.2018 ka bashkelidhur dy faturat perkatese me te dhenat per makinerite, te cilat vertetojen se qeradhenesi i ketyre makinerive i disponon keto makineri. Nuk e kuptojme se cili dokumentacion konkretisht i mungon dhe cfare dokumentacioni kerkon autoriteti kontraktor kur nuk eshte kerkuar asnje dokumentacion specifik nga ana e vete autoritetit kontraktor. Edhe ky shkak skualifikimi i dhene nga autoriteti kontraktor nuk qendron, pasi edhe si arsye skualifikimi nuk eshte e plote apo e sakte por thjesht evazive pa dhene detaje. Bashkelidhur keni kontraten dhe faturat bashkelidhur ashtu sic jane paraqitur edhe ne SPE. Per arsyen e trete sqarojme se autoriteti kontraktor ne sistem thote vetem qe i mungon dokumentacioni bashkelidhur ndersa kur kthen pergjigje i referohet per mungese dokumentacioni nje fjalie ne kontraten e qerases se paraqitur per makineri ku thuhet "sipas dokumentacionit bashkelidhur", duke e quajtur te pavlefshme kete kontrate sepse nuk eshte bashkelidhur dokumentacioni. Sqarojme se nga ana jone eshte bashkelidhur gjithë dokumentacioni i duhur si fatura tatimore, te cilat jane bashkengjitur ne sistemin e prokurimeve elektronike, nderkohe qe sqarojme se argumenti i paraqitur nga autoriteti kontraktor se mungesa e ketij dokumentacioni e ben kontraten te pavlefshme nuk qendron dhe nuk ka vlere sepse kontrata e qerases i ka te gjitha te dhenat dhe elementet konkrete ne perputhje me kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderi. Kontrates se qerases nuk i mungon asnje dokumentacion bashkelidhur duke perfshire te gjitha funksionet e ketyre dy makinerive, dhe permban te gjitha te dhenat e duhura, dhe nese ka mungesa sic citon autoriteti kontraktor kjo mungese nuk cenon absolutisht dokumentin e paraqitur.

4. Per shkakun e skualifikimit se njera nga etiketat , modeli E10 ngjyre jeshile (njeri nga modelet e dorezuara e ka emertimin F10 jo E10), duam te sqarojme se pari se keto jane mostra pra nuk eshte modeli perfundimtar qe do i vihet ne dispozicion OE fitues kur te filloj egzekutimi i kontrates . Per me teper ky model nga AK ne sistem eshte publikuar i bardh (dhe jo si grafike perfundimtare per tu referuar OE ne pergatitjen e sample pasi ne specifikime teknike jane cituar te tjera detaje teknike nderkohe qe nga ana jone kjo moster eshte paraqitur konform te gjitha specifikimeve teknike pra keto specifikime teknike jane permbushur te plota per kete model si lloji i letres, ana grafike, ngjyra, dimensionet etj. Fakti i vendosjes se germes F10 ne vend te E10 nuk eshte shkak per skualifikimi pasi nese operatori ekonomik eshte ne gjendje te shkruaje ne te germen F do te thote se eshte ne gjendje te shkruaje ne te edhe germen E pra eshte nje fakt lehtesisht i realizueshem per sa kohe qe prej shoqerise sone eshte realizuar fakti i shkrimit te nje germe. Sqarojme se ne fund te fundit etiketa nuk ka vetem kete germe si element por edhe shume tekste te tjera, dhe eshte sample nuk eshte modeli perfundimtar dhe per aq kohe sa cdo gje tjeter teknike eshte shume ne rregull me specifikimet (lloji letres dhe dimensionet), kjo nuk do te thote qe nuk mund te behet dhe germa F nderkohe qe eshte shkruar nje germe e tille. Theksojme se ky nuk eshte file perfundimtar dhe perderisa me metoden e grafikut u prodhuar germa F po me te njejten menyre do te behet edhe E. Per piken e katert sqarojme edhe njehere se keto mostra jane modele pra nuk jane perfundimtare dhe autoriteti kontraktor nuk ka dhene ndonje arsye apo sqarim ne lidhje me kete shkak skualifikimi. Ashtu sic kemi thene edhe ne ankese perderisa shoqeria jone ka bere ne rregull mostren me te gjitha te dhenat e tjera specifike normalisht nuk ka asnje pengese per te realizuar edhe germen F, po ne te njejten menyre do te behej edhe germa E

5. Per arsyen e skualifikimit per etiketat Barcode qe nga leximi qe i ka bere AK kane rezultuar te pavlefshme disa modele te tyre jo te gjitha me konkretisht (CP-AL , RR-AA , RR-AL) theksojme se

pari se nga ana jone eshte bere prodhimi i te gjitha modeleve te kerkuara sipas dokumentave te autoritetit kontraktor dhe specifikimeve teknike. Pra duam te sqarojme dhe themi me argumenta te forta se prodhimi i te gjitha modeleve te etiketave barcode qe jane kerkuar ne dokumentat e tenderit nga ana juaj jane prodhuar te gjitha sipas specifikimeve teknike dhe me kryesorja me te njejten teknologji prodhimi. Duke u bere me te njejten teknologji nuk ka asnje mundesi se si te ndodhe kjo gje qe disa lexohen e disa jo. Nga ana tjeter autoriteti kontraktor nuk mund te dale ne te tilla perfundime duke mos vepruar sic ka vepruar ne vitet e meparshme, qe gjithnje pasi ne jemi shoqeri te interesuar per kete procedure prokurimi dhe kemi marre pjese ne te gjitha procedurat e prokurimit qe zhvillon autoriteti juaj, autoriteti kontraktor ne te gjitha rastet e meparshme ka bere testimin e modeleve te paraqitura ne prani te gjithe operateve ekonomike gje qe nuk e beri kete vit duke lene vend per abuzime dhe keqkuptime dhe duke sjelle skualifikimin me pa te drejte te shoqerise sone. Nuk mundet se si disa nga modelet tona te paraqitura lexohen e disa jo kur nga ana jone jane prodhuar te gjitha me te njejten teknologji ndaj nje gje e tille eshte e pamundur. Autoriteti kontraktor duhet te kishte bere hapjen dhe testimin e tyre ne prani te operateve ekonomike me qellim pranimin e gjithsecilit operator per keto modele te paraqitura. Autoriteti kontraktor kur kthen pergjigje jep arsye te ndryshme nga ajo e dhene ne sistemin e prokurimeve elektronike ne lidhje me barcodet, ku sipas AK keto barcode jane te pavlefshme pasi jane perdorur me pare sqarojme se kodet jane bere te gjitha me te njejten teknologji ndaj ky argument i autoritetit kontraktor nuk qendron dhe nuk ka mundesi si te ndodhe nje gje e tille.

Nga ana tjeter AK ka kualifikuar shoqerine M&D qe asnje nga samples qe u hapen (jo barcode se ato nuk u testuan vetem u verifikuan si numer dhe si emertime) nuk ishte konform me specifikimet teknike, te pakten kjo nga komentet e vete AK ditën e hapjes se ofertave dhe dorezimit te mostrave , duke ngritur dyshimet tona edhe nga verifikimi i aty per aty qe keto sample te kesaj shoqerie nuk plotesojne specifikimet teknike dhe kerkesat e autoritetit kontraktor.[...]”

II.6.Në datën 24.10.2018, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1578/17prot., datë 22.10.2018 ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7.Me anë të shkresës, nr.1585/4prot., datë 26.11.2018, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a. dhe operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k, janë njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, se në datën 04.12.2018, në orën 10⁰⁰ do të organizohet një seancë dëgjimore pranë KPP-së, ku do të parashtrihen pretendimet e operatorit ekonomik ankimues si dhe faktet e paraqitura nga autoriteti kontraktor lidhur me skualifikimin e këtij operatori ekonomik nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi lidhur me arsyet e skualifikimit: “- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 13 Etiketa Bar Code për kolipostën CP-AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. - Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 15 Etiketa Bar Code për postën RR-AA, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. - Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 16 Etiketa Bar Code për postën RR-AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi.”

II.8. Në datën 04.12.2018, në orën 10⁰⁰ u zhvillua seanca dëgjimore pranë KPP-së, në të cilën, të dy palët e njoftuara, u paraqitën dhe parashtruan faktet dhe pretendimet e tyre mbi arsyen e skualifikimit të sipërcituar.

II.9. Në datën 05.12.2018, në orën 10⁰⁰ u zhvillua seanca e dytë dëgjimore pranë ambjenteve të autoritetit kontraktor, me qëllim verifikimin dhe testimin e mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues ”Adel Co” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin: “[...]”-Ne kemi bindjen se objekti i certifikatave të shoqërisë Marketing & Distribution shpk nuk perputhet me objektin e kontratës që prokutohet. Pra, ky operator vertet është i certifikuar me certifikata ISO 14001 dhe OHSAS 18001, por keto certifikata nuk kanë asnjë vlerë në rastin e procedurës përkatëse. Referuar kërkesës për ISO 14001, objekti i certifikatës nuk perputhet me objektin e prokurimit shtypshkrime, dhe përveç kësaj sikurse tregohet edhe në listën që verteton akreditimin, trupa certifikuese nuk është e akredituar të leshojë certifikata për kompanitë që operojnë në fushën e shtypshkrimeve. E njëjta gjë edhe për Certifikatën Ohsas 18001 [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr. 9, pika 2.2.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.2.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikate ISO 27001: 2013; (ose ekuivalente)
- Certifikate ISO 14298 : 2013 (certifikatë sigurie shtypi); (ose ekuivalente)
- Certifikate ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente)
- Si dhe Certifikate OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente)

Certifikatat e mësipërme të jënë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”

III.1.2. Me anë të shtojcës “Njoftim modifikimi”, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e sipërcituar si më poshtë vijon:

“Kriteri 2.2.5. ishte: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatë ISO 27001: 2013; (ose ekuivalente)
- Certifikatë ISO 14298 : 2013 (certifikatë sigurie shtypi); (ose ekuivalente)
- Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente)
- Si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente)

Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri 2.2.5. bëhet: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente)
- Si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente)

Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”

III.1.3.Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Çertifikatë BS OHSAS 18001 : 2007, lëshuar nga trupa certifikuese ICDQ, e vlefshme për fushat e aktiviteteve : Importim, tregtim dhe shpërndarje të detergjentëve, produkte për higjenën personale, artikuj për pastrimin e shtëpisë(midis të cilave aromatizues dhe dizinfektues), cigare, ushqime të paketuara të freskëta dhe jo të freskëta(midis të cilave pijet alkoolike dhe jo alkoolike), artikuj për zyra – kancelari – bojëra printeri dhe fotokopje – aksesore për kompjuter, produkte për telefoninë mobile.
2. Çertifikatë akreditimi nr.846-2 lëshuar nga organizmi akreditues ESYD, me anë të së cilës akreditohet trupa certifikuese ICDQ, për të kryer auditime dhe certifikime, shoqëruar me anekset e kësaj certificate A1/5 dhe A2/4.
3. Çertifikatë UNE-EN ISO 14001 : 2015, lëshuar nga trupa certifikuese ICDQ, e vlefshme për fushat e aktiviteteve : Importim, tregtim dhe shpërndarje të detergjentëve, produkteve për higjenën personale, artikuj për pastrimin e shtëpisë(midis të cilave aromatizues dhe dizinfektues), cigare, ushqime të paketuara të freskëta dhe jo të freskëta(midis të cilave pijet alkoolike dhe jo alkoolike), artikuj për zyra – kancelari – bojëra printeri dhe fotokopje – aksesore për kompjuter, produkte për telefoninë mobile.
4. Çertifikatë akreditimi 17/C-MA026 lëshuar nga organizmi akreditues ENAC, me anë të së cilës akreditohet trupa certifikuese ICDQ, për të kryer auditime dhe certifikime, shoqëruar me aneksin teknik të kësaj certificate.

III.1.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.5.Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

1.Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.6.Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e

asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 14001 : 2004 ose ekuivalente dhe OSHAS 18001 : 2007 ose ekuivalente. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k., për të vërtetuar se kryen aktivitetin e tij sipas standarteve për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ka paraqitur certifikatën BS OHSAS 18001 : 2007, lëshuar nga trupa certifikuese ICDQ. Ndërsa për të vërtetuar se kryen aktivitetin e tij sipas standarteve mbi menaxhimin mjedisor ka paraqitur, ka paraqitur Çertifikatë UNE-EN ISO 14001 : 2015, lëshuar nga trupa certifikuese ICDQ. Këto certifikata, janë lëshuar për fushat e aktiviteteve : « *Importim, tregtim dhe shpërndarje të detergjentëve, produkte për higjenën personale, artikuj për pastrimin e shtëpisë (midis të cilave aromatizues dhe dizinfektues), cigare, ushqime të paketuara të freskëta dhe jo të freskëta (midis të cilave pijet alkoolike dhe jo alkoolike), artikuj për zyra – kancelari – bojëra printeri dhe fotokopje – aksesore për kompjuter, produkte për telefoninë mobile* »

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar rekomandimi mbi hartimin e kërkesave të cilësisë i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, datë 20.03.2018 (data e protokollimit pranë APP), shoqëruar me Manualin teknik “*Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë*”.

Në këtë rekomandim, është përcaktuar: “*Të gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkohen nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë*”.

Gjithashtu, në manualin teknik, përcaktohen mënyrat, se si merret informacioni për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë. Në këtë manual janë të përcaktuara detajet në lidhje me organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, mënyrën se si mund të merret informacioni nëse një OVK është i akredituar apo jo nga DPA, mënyrën se si mund të merret informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK e akredituar është aktualisht i vlefshëm, si mund të merret informacion nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj, mënyrën si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit.

III.1.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k., si dhe nga verifikimet e kryera sipas udhëzimeve në manualin teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, rezulton se trupa certifikuese ICDQ është akredituar për auditime dhe certifikime për standartin OSHAS 18001 : 2007 për aktivitetet ekonomike sipas kodeve EA/IAF 17, 24, 28, 29, 30, 31, 35 dhe 39 nga organizmi akreditues ESYD (organizëm palë

në marrëveshjen e bashkëpunimit EA), si dhe është akredituar për auditime dhe certifikime për standartin UNE-EN ISO 14001 : 2015 për aktivitetet ekonomike sipas kodeve EA/IAF 1, 2, 3, 4, 5, 8, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37 dhe 39 nga organizmi akreditues ENAC (organizëm palë në marrëveshjet e bashkëpunimit EA, IAF dhe ILAC). Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k., nuk është i certifikuar për standartet e kërkuara lidhur me cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe menaxhimin mjedisor për aktivitetin ekonomik që do të kryej për zbatimin e kontratës objekt prokurimi (shërbime printimi). Nga ana tjetër, certifikatat OSHAS 18001 : 2007; UNE-EN ISO 14001 : 2015, të paraqitura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k. janë lëshuar nga një trupë certifikuese e cila nuk është e akredituar për të audituar apo certifikuar në këto standarte për aktivitetin objekt proukrimi, aktivitet i cili, sipas EA/IAF ka kodin 9 “Kompani Printimi” ose kodin NACE 18, sipas dokumentit udhëzues të Organizmit European të Akreditimit, që bazohen në aneksin 1, të rishikimit 2, të “NACE- National Classifications of Economic Activities” (Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve Ekonomike), miratuar në Rregulloren (EC) të Parlamentit European nr.1893/2006. Komisioni gjykon se, trupat certifikuese duhet të jenë të akredituara në mënyrë vecantë për secilin aktivitet ekonomik sipas klasifikimit kombëtar të miratuar nga Parlamenti European, pasi këto aktivitete janë totalisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe kanë secila specifika dhe kërkesa të vecanta lidhur me plotësimin e standarteve, e për rrjedhojë akreditimi i një trupe certifikuese për auditim dhe certifikim në një standart të caktuar, për një apo disa prej aktiviteteve ekonomike, nuk e bën këtë të fundit automatikisht të akredituar për të audituar dhe certifikuar kompani në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k. ka paraqitur certifikata BS OHSAS 18001 : 2007 dhe UNE-EN ISO 14001 : 2015, jo për aktivitetin objekt prokurimi, si dhe të lëshuara nga një trupë certifikuese e cila nuk është e akredituar për certifikimin e kompanive që kryejnë shërbimet e printimit, e për rrjedhojë nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 9, pika 2.2.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën përkatëse, pasi këto certifikata nuk vërtetojnë nëse ky operator ekonomik plotëson standartet e kërkuara për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe menaxhimin mjedisor për aktivitetin ekonomik që do të kryej për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Fakti që një operator ekonomik është i certifikuar sipas standarteve ISO 18001 dhe ISO 14001, për një apo disa prej aktiviteteve ekonomike, nuk e bën këtë të fundit automatikisht të certifikuar sipas standarteve të mësipërme në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike. Akti nënligjor VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në nenin 30 të saj sanksionon qartë se certifikatat për kërkesat e cilësisë kërkojnë nga autoriteti kontraktor për të vërtetuar se punët/shërbimet/mallrat objekt prokurimi plotësojnë standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k. qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes “Adel Co” sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë pasi operatori ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë

gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “[...]- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 13 Etiketa Bar Code për kolipostën CP AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. - Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 15 Etiketa Bar Code për postën RR- AA, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. - Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht zëri numër 16 Etiketa Bar Code për postën RR- AL, në momentin e testimit ka rezultuar e pavlefshme gjatë leximit nga sistemi. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik Vëren se:

III.3.1.Në shtojcën nr. 9, pika 2.2.7 “Kapaciteti Teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.2.7. Operatori Ekonomik ne daten dhe oren e hapjes se ofertave duhet te paraqese dorazi mostra/modele per zerat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40,41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 te percaktuara ne sasise dhe grafikun e levrimit dhe sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Operatori Ekonomik, per artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet te paraqesi te pakten nga 100 cope etiketa per secilin. Barkodi per keto etiketa duhet te realizohet sipas algoritmit te dhene ne specifikimet teknike, pasi ne momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet te rezultoje i vlefshem dhe te lexohet nga sistemi. Gjithashtu per artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10 OE duhet te paraqesi nga 100 cope per secilin”

III.3.2.Me anë të shtojcës “Njoftim modifikimi 4”, autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e procedurës së prokurimi objekt shqyrtimi si më poshtë vijon:

Kriteri 2.2.3 ishte: Operatori ekonomik duhet të disponojë:

-makineri parapërgatitje CTP;

-makineri shtypi në rrulon;

-makineri telefonimi;

-si dhe makineri për mbledhjen e letrës me birosje.

Disponimi i makinerive të mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontratë qeraje të noterizuar.

Kriteri 2.2.3 bëhet: Operatori ekonomik duhet të disponojë:

-makineri parapërgatitje CTP;

-makineri shtypi në rrulon;

-makineri telefonimi;

-makineri për mbledhjen e letrës;

-si dhe makineri për birosjen e letrës.

Kriteri 2.2.7 ishte: Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40,41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 të përcaktuara në sasisë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik, për artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet të paraqesi të paktën nga 100 copë etiketa për secilin. Barkodi për këto etiketa duhet të

realizohet sipas algoritmit të dhënë në specifikimet teknike, pasi në momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet të rezultojë i vlefshëm dhe të lexohet nga sistemi.

Gjithashtu për artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10 OE duhet të paraqesi nga 100 copë për secilin.

Kriteri 2.2.7 bëhet: Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 të përcaktuara në sasisë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik, për artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet të paraqesi vetëm nga një ekzemplar (mostër) për secilin produkt që do të prokurohet.

Barkodi për këto etiketa duhet të realizohet sipas algoritmit të dhënë në specifikimet teknike, pasi në momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet të rezultojë i vlefshëm dhe të lexohet nga sistemi. Gjithashtu për artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10 OE duhet të paraqesi nga një ekzemplar (mostër) për secilin.

III.3.3. Në shtojcën nr. 10, pikat 32, 33 dhe 35 “Specifikimet teknike të shtypshkrimeve për vitin 2018” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“32. Etikete barekod RR.....AA për postën e letrave brenda vendit

-Fusha e bardhe

-Shkrimi I zi me 13 karakter.

-Sipas algoritmit code(128)

-Permasat e kodit 55x15mm

- Ne formë drejtkëndore.

-Te paketuara në rulone me 500 copë

-Distanca e fillimit kodit duhet të jetë 5 mm nga të katër anët.

-Shkrimi I tekstit 3mm.

- Kodi që enkodohet në barkod ka 13 karaktere dhe nuk përmban hapësira.

Shih. **Modelin 1 code 128**

Modeli 1-barkode sipas algoritmit code 128

33. Etikete barekod RR.....AL për postën e letrave jashtë vendit

-Fusha e bardhe

-Shkrimi I zi me 13 karakter.

-Sipas algoritmit code(128)

-Permasat e kodit 55x15mm

- Ne formë drejtkëndore.

-Te paketuara në rulone me 500 copë

-Distanca e fillimit kodit duhet të jetë 5 mm nga të katër anët.

-Shkrimi I tekstit 3mm.

- Kodi që enkodohet në barkod ka 13 karaktere dhe nuk përmban hapësira.

Shih **modelin 1 code 128**



ALGORITMI

RR-XXXXXXXX-K-AL

RR- rekomande

AL- Albania (jashte vendit)

AA- brenda vendit

X-jane 8 shifra te cfarëdoshme

K- është një numër kyç, i cili llogaritet me një formulë të vecantë

K është i rëndësishëm dhe llogaritet në këtë mënyrë.

Numra çfarëdo	4	7	3	1	2	4	8	2
---------------	---	---	---	---	---	---	---	---

Shumëzuesi fiks	x8	x6	x4	x2	x3	x5	x9	x7
-----------------	----	----	----	----	----	----	----	----

<u>Rezultati</u>	32	+	42	+	12	+	2	+	6	+	20	+	72	+	14	=	200
------------------	----	---	----	---	----	---	---	---	---	---	----	---	----	---	----	---	-----

200 pjestohet me 11 dhe jep 18 me mbetje 2

11-2 =9

K=9

Nqs **K** = 10 atëherë K behet 0.

Nqs **K** = 11 atëherë K behet 5.

K nuk ndryshohet kur **K** është nga 1 deri ne 9

Kontrast i larte mes te bardhës e te zezës.

Barkodet:Standarti i barkodeve duhet të jetë **code128**, ky është formati që njihet nga sistemi IPS dhe nga UPU

Ky algoritem eshte I njejte per te gjithë barkodet per sherbimin postar, RR, kolipostar CP, EMS EE, Ekspres Brendshem EB,EN.

35.Etikete barekod CP.....AL per Koliposten jashte vendit

-Fusha e bardhe

-Shkrimi I zi me 13 karakter.

-sipas algoritmit code(128)

-Permasat e kodit 55x15mm

- Ne forme drejtkendore..

-Te paketuara ne rulone me 500 cope

-distanca e fillimit kodit duhet te jete 5 mm nga te kater anet.

-Shkrimi I tekstit 3mm.

- kodi qe enkodohet ne barkod ka 13 karaktere dhe nuk përmban hapësira.

Shih. Modelin 1 code 128”

III.3.3.Në nenin 53/3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.4.Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose”*

III.3.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se verifikimi dhe testimi i mostrave “Etiketa barkode”, nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk është kryer në prezencë të operatorëve ekonomik të cilët kanë paraqitur këto mostra. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik e pati të pamundur të testojë dhe të verifikojë vlefshmërinë e këtyre etiketave barkode, të dorëzuara në cilësinë e mostrës nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor, si pasojë e mosdisponimit të pajisjes e cila i lexon ato. Në këto kushte, me qëllim verifikimin dhe testimin e këtyre mostrave, me anë të shkresës, nr.1585/4prot., datë 26.11.2018, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a. dhe operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k, janë njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, se në datën 04.12.2018, në orën 10⁰⁰ do të organizohet një seancë dëgjimore pranë KPP-së.

Në datën dhe orën e caktuar, u paraqitën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përfaqësuesit e palëve të sipërcituara, të cilët paraqitën përpara Komisionit, faktet dhe pretendimet e tyre mbi pavlefshmërinë e mostrave CP-AL, RR-AL dhe RR-AA, të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. Por, në pamundësi për të disponuar pajisjen e leximit të barkodeve nga ana e autoritetit kontraktor në ambjentet e Komisionit të Prokurimit Publik, me dakordësinë e palëve, në datën 05.12.2018, ora 10⁰⁰ u zhvillua një seancë e dytë dëgjimore pranë ambjenteve të autoritetit kontraktor, në të cilën, në prezencë të përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimues dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, u krye testimi i etiketave barkode CP-AL, RR-AL dhe RR-AA, të dorëzuara në cilësinë e mostrës nga ankimuesi.

III.3.6. Në seancën dëgjimore ankimuesi, sikurse ka parashtruar edhe në ankesë, pretendon se: *“Duam të sqarojmë dhe themi me argumenta të forta se prodhimi i të gjitha modeleve të etiketave barcode që janë kerkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë prodhuar të gjitha sipas specifikimeve teknike dhe me kryesorja me të njëjtën teknologji prodhimi. Duke u bërë me të njëjtën teknologji nuk ka asnjë mundësi se si të ndodhe kjo gjë që disa lexohen e disa jo.”* Ndërsa, autoriteti kontraktor, sikurse parashtron në aktin e trajtimit të ankesës të paraqitur pranë tyre, ashtu edhe në seancën dëgjimore sqaron se: *“AK nuk ngre pretendime mbi teknologjinë e prodhimit të etiketave Bar Code por gjatë testimit me “Bar Code Reader” ka rezultuar që këto etiketa të paraqitura janë etiketa me kode të përsëritura që do të thotë se këto Bar Cod të etiketave janë të përdorura më parë dhe si rrjedhojë janë të pavlefshme gjatë leximit nga sistemi.”*

III.3.6.Pas diskutimeve dhe parashitimeve të pretendimeve nga palët, nga testimi i mostrave, në mënyrë rastësore, të etiketave barkode CP-AL, RR-AL dhe RR-AA, të paraqitura nga ankimuesi në cilësinë e mostrës pranë autoritetit kontraktor, u konstatua si vijon:

-Nga 3 (tre) etiketa RR-AL të testuara, që të treja rezultuan të pavlefshme nga sistemi, pasi ishin të përdorura nga sistemi postar i Posta Shqiptare sh.a. në vitin 2013.

-Nga 3 (tre) etiketa CP-AL të testuara, një etikë rezultoi e vlefshme, ndërsa dy etiketë rezultuan të pavlefshme, pasi ishin përdorur nga sistemi postar i Posta Shqiptare sh.a. në vitin 2014.

-Nga 3 (tre) etiketa RR-AA të testuara, që të treja rezultuan të pavlefshme nga sistemi, pasi ishin të përdorura nga sistemi postar i Posta Shqiptare sh.a. në vitin 2013.

III.3.7.Bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, sqarimet e autoritetit kontraktor, si dhe verifikimet e kryera, Komisioni konstaton se mostrat etiketa barkode CP-AL, RR-AL dhe RR-AA, të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. dhe të administruara autoriteti kontraktor, nuk rezultojnë të vlefshme sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në shtojcën nr. 9, pika 2.2.7 “Kapaciteti Teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, të ndryshuar me shtojcën përkatëse, si dhe sipas specifikimeve teknike. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, mostrat etiketa barkode, përvec specifikimit të detyrueshëm që duhet të jenë Code 128 dhe të lexohen nga sistemi, duhet të prodhohen sipas algoritmit të përcaktuar në shtojcën 10, specifikimet teknike, në mënyrë që rezultojnë të vlefshme nga sistemi postar i Postës Shqiptare sh.a. Nga verifikimet e kryera, Komisioni konstaton se sistemi elektronik i barkodeve i cili përdoret nga Posta Shqiptare sh.a., është sistem ndërkombëtar postar, i cili është pjesë e UPU (Unioni Universal Postar) sipas protokollit të mirëpërcaktuar nga Konventa Universale Postare. Në protokollin e sipërcituar, përcaktohet se sistemet, specifikimet teknike dhe algoritmet e barkodeve të cilat përdoren për objektet postare, përcaktohen nga UPU (Unioni Universal Postar) dhe nuk lihet në diskrecion të kompanive postare të cilat janë pjesë e këtij unioni. Në këto kushte, bazuar në kompleksitetin e këtij produkti, Komisioni gjykon se, operatorët ekonomik pjesëmarrës, nëpërmjet mostrave të paraqitura, përvec prodhimit sipas përmasave dhe teknologjisë të përcaktuar në specifikimet teknike në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, duhet të vërtetojnë dhe të krijojnë bindjen se kanë aftësinë dhe kapacitetet e nevojshme për të prodhuar etiketa barkode të vlefshme për sistemin sipas algoritmeve të përcaktuara nga UPU dhe të papërdorura më parë, pasi nga verifikimet e kryera, barkodet e përdorura më parë, nuk pranohen më nga sistemi elektronik postar. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se mostrat etiketa barkode CP-AL, RR-AL dhe RR-AA, të paraqitura nga ankimuesi nuk mund të konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.8. KPP gjykon, se kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Blerje Shtypshkrimesh”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.

6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1585 protokoli Datë 11.10.2018; Nr. 1588 protokoli Datë 12.10.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha